



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE**  
**-Këshilli Drejtues-**

---

**V E N D I M**

**Nr.2553, datë 10.04.2015**

**“Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit “Albanian Mobile Communication”  
sh.a. për dy të drejta përdorimi në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet  
GSM/LTE/UMTS/WiMAX”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare Znj. M.Drushku, në mbledhjen e datës 10.04.2015, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, dhe Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP, shqyrtoi çështjen me objekt:

**Për dhënien e Autorizimit Individual sipërmarrësit “Albanian Mobile Communication”  
sh.a. për dy të drejta përdorimi në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet  
GSM/LTE/UMTS/WiMAX”**

**BAZA LIGJORE:**

1. Ligji Nr 8485 datë 12.05.1999, “Kodi i procedurave administrative”;
2. Shkronja g, e nenit 8, nenet 62 deri 79 të ligjit 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (ligji nr. 9918 i ndryshuar me ligjin nr. 102/2012 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në republikën e Shqipërisë”);
3. Vendimi Nr.466, datë 27.2.2013 “Per miratimin e Planit Kombetar te Frekuencave”.

4. Vendimi Nr. 1252, date 10.9.2008, te Keshillit te Ministrave “Per miratimin e rregullave te zhvillimit te tenderit publik, per dhenien e se drejtes se perdorimit te frekuencave” i ndryshuar,
5. Rregullore për Autorizimin Individual, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 2395 datë. 15.12.2013.
6. Vendimi i Këshillit Drejtues Nr.2548, datë 20.03.2015 për “Miratimin e Raportit Përmbledhës të KVO dhe Njoftimin e fituesve të Tenderit publik me procedurë të hapur me objekt: “*Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX*”, Ref. 6-2x6-2015.
7. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

### **K Ë S H I L L I D R E J T U E S :**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

- Kopje e Faturave te pagesave të kryera nga sipërmarrësi “**Albanian Mobile Communication**” sh.a
  - Relacion shpjegues mbi Projekt-Vendimin (*Relacioni*);
  - si dhe,
- duke i`u referuar diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar.

### **V Ë R E N :**

1. Këshilli Drejtues i AKEP, me Vendimin Nr. 2548, datë 20.03.2015, në përfundim të tenderit publik me procedurë të hapur, me objekt “*Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX*”, Ref. 6-2x6-2015, miratoi:
  - a) Raportin Përmbledhës të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në të cilin oferta e sipërmarrësit “Albanian Mobile Communication ” sh.a identifikohet si ofertë fituese.
  - b) Njoftimin e Fituesit, sipas Shtojca 16 - Formulari i Njoftimit të Fituesit.
2. AKEP, bashkëlidhur shkresës Nr.499/11 Prot., datë 20.03.2015 i ka dërguar “Albanian Mobile Communication” sh.a., Formularin e Njoftimit të Fituesit, Nr.499/10 Prot., datë 20.03.2015, sipas Shtojca 16, të përfshirë në dokumentacionin e tenderit.
3. “Albanian Mobile Communication” sh.a brenda afatit 7 (shtatë) ditë, nga data marrjes së Formularit të njoftimit të fituesit, njoftoi kryerjen e pagesave, të mëposhtëme:

- a) Çmimin e ofertës me shumën prej **9.029.441** (nëntë milion e njëzet e nëntë mijë e katërqind e dyzet e një) **Euro**, më datë 26.03.2015, në Logarinë bankare me emërtim: *Qeveria Shqiptare*.
- b) Pagesën vjetore (për 9 muaj) **1,890,000 lekë** (një milion e tetëqind e nëntëdhjetë mijë) për përdorimin e dy të drejtave të përdorimit 2x6 MHz të frekuencave të brezit 1800 MHz.
- c) Pagesën vjetore (për 9 muaj) **4,300,800 lekë** (katër milion e treqind mijë e tetëqind) për tarifën e shërbimit për shërbimet e radiokomunikimit, për te drejtat e përdorimit 2x6 MHz të frekuencave të brezit 1800 MHz.

Pagesa sipas pika a) të mësipërme, është kryer në Bankën e Shqipërisë, *Qeveria Shqiptare* në EUR me Nr: AL89 1011 1008 0000 0000 2111 001E .

Pagesat sipas pika b) dhe c) të mësipërme, janë kryer në llogarinë bankare të AKEP, me Nr: AL30214112090 111113869030117.

## P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në sa më sipër, në kompetencat që i janë dhënë nga:

1. Ligji Nr.8485 dt 12.05.1999 “Kodi i procedurave administrative”;
2. Ligji Nr. 9918, datë 19.05.2008, për “Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, gërma g, neni 8, nenet 62 deri 79, neni 114 dhe neni 115 ,
3. VKM Nr.466, datë 27.2.2013 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Frekuencave”,
4. Vendimet e Këshillit të Ministrave Nr.1252, datë 10.9.2008, i ndryshuar,
5. Rregullorja për Autorizimin Individual, miratuar me VKD Nr. 2395 datë. 15.12.2013.
6. Rregullore e Brendshme e AKEP, miratuar me Vendimin Nr.2506, datë 30.10.2014 të Këshillit Drejtues të AKEP.

## V E N D O S :

1. Të pajisë sipërmarrësin “ Albanian Mobile Communication” sh.a me Autorizim Individual për përdorimin e dy të drejtave nga 2x6 MHz në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij Vendimi.
2. Sipërmarrësi do të shfytëzojë frekuencat e dhëna nëpërmjet procedurës së tenderit publik me objekt “**Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX**”, Ref. **6-2x6-2015**, në përputhje me kushtet e pranuar të Dokumentit të Tenderit.

3. Afati i vlefshmërisë së Autorizimit Individual për dy të drejtat e përdorimit 2x6 MHz të fituara nëpërmjet tenderit me objekt “*Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX*”, Ref. 6-2x6-2015 do të jetë 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, nga 01.04.2015 deri në 01.04.2030.
4. Vendosija në spektër, brezi 1800 MHz, dhe fillimi i shfrytëzimit të këtij spektri në përputhje me kushtet e vendosura në Autorizimin Individual bashkëlidhur këtij vendimi do të njoftohen me një vendim tjetër të AKEP.
5. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al).

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R**

**Piro XHIXHO**

**ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:**

1. **Alban KARAPICI** \_\_\_\_\_
2. **Anila DENAJ** \_\_\_\_\_
3. **Ketrin TOPÇIU** \_\_\_\_\_
4. **Klarina ALLUSHI** \_\_\_\_\_